

FAKTE TË
SHPEJTA
MBI GJININË
DHE
ARMËT E
ZJARRIT
NË
SHQIPËRI

Zyra Qendrore e Evropës Lindore dhe Juglindore për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta (SEESAC) është një iniciativë e përbashkët e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (KBR) e cila ka për qëllim forcimin e kapaciteteve kombëtare dhe rajonale për kontrollin dhe pakësimin e përhapjes dhe keqpërdorimit të armëve të vogla dhe të lehta, duke kontribuar kështu në rritjen e stabilitetit, të sigurisë dhe të zhvillimit në Evropën Juglindore dhe Lindore.

Botimi i “Fakte të shpejta mbi gjininë dhe armët e zjarrit në Shqipëri” u mundësua me kontributin e Bashkimit Evropian, përmes Vendimit të Këshillit të BE-së (CFSP) 2016/2356 në mbështetje të veprimtarive të SEESAC për çarmatimin dhe kontrollin e armëve në Evropën Juglindore.

Për më shumë informacion, kontaktoni:

Menaxherin e projektit të SEESAC
Bulevar Zorana Dindića 64, 11000, Beograd, Serbi
Tel: +381 11 415 5300 Faks: +381 11 415 5359
www.seesac.org

Falënderime:

Dëshirojmë të shprehim mirënjohjen tonë për Komisionin e Armëve të Vogla dhe të Lehta (AVL) për mbështetjen thelbësore në mbledhjen e të dhënave, të cilat bënë të mundur këtë raport. Ky raport gjithashtu është pasuruar me kontributet dhe komentet e anëtarëve të ekipit të SEESAC Juliana Buzi dhe Teodora Zafiu.

Fakte të shpejta mbi gjininë dhe armët e zjarrit në Shqipëri

Ky raport u hartua nga Dragan Božanić, Specialist i projektit të SEESAC për hulumtimet dhe çështjet gjinore. Dušan Đukić, konsulent i nivelit “junior”, ofroi mbështetje për hartimin e raportit. Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument jo domosdoshmërisht pasqyrojnë pikëpamjet e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal apo të Bashkimit Evropian. Përcaktimet e përdorura dhe prezantimi i materialeve në këtë publikim nuk nënkuptojnë shprehjen e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal, ose të Bashkimit Evropian për sa i përket 1) statusit ligjor të secilit vend, territor ose zonë, ose të autoriteteve apo grupeve të tij të armatosura; ose 2) për vijëzimin e kufijve të tij.

Dizajni dhe paraqitja grafike: Vladimir Garboš

Garantimi i cilësisë së dizajnit: Marina Ileš

Printuar nga: Cicero

Tirazhi: 100 kopje

© SEESAC 2019 - Të gjitha të drejtat të rezervuara

FAKTE TË SHPEJTA MBI GJININË DHE ARMËT E ZJARRIT NË SHQIPËRI

Rreth buletinit me fakte të shpejta

Buletini me fakte të shpejta mbi gjininë dhe armët e vogla dokumenton lidhjet e shumta ndërmjet gjinisë dhe armëve të vogla në Evropën Juglindore (EJL) dhe nënvizon rreziqet specifike me të cilat përballen gratë dhe burrat lidhur me përdorimin dhe keqpërdorimin e armëve të zjarrit.

Faktet e shpejta japin një panoramë të përgjithshme të të dhënave të ndara sipas seksit, lidhur me pronësinë, aksesin, kërkesën për armë zjarri dhe ndikimin e tyre te gratë dhe burrat, duke përfshirë keqpërdorimin e armëve të zjarrit në kontekstin e dhunës në familje.

Nëpërmjet aksesit të përmirësuar në të dhënat e ndara sipas seksit, *faktet e shpejta* përpiqen të rrisin njohurinë dhe ndërgjegjësimin e profesionistëve dhe të publikut të gjerë rreth aspekteve tejet gjinore të armëve të vogla. Gjithashtu, informacionet i ofrojnë politikëbërësve në Shqipëri një instrument të lehtë për t'u përdorur në hartimin e politikave të bazuara në fakte dhe integrimin e gjinisë në legjislacionin dhe politikat për kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta.

Burimet e të dhënave

Të dhënat e përdorura në faktet e shpejta janë marrë nga disa burime:

1. Anketimi për shpërndarjen dhe ndikimin: Në bashkëpunim me qeveritë në EJL, SEESAC mbledhi dhe analizoi të dhëna për të identifikuar tendencat në shpërndarjen e armëve të vogla (veçanërisht për sa i përket llojit, sasisë, zotërimit, shpërndarjes, tregtisë së ligjshme/jashtëligjshme, prodhimit dhe lëvizjes së armëve të vogla dhe të lehta) si dhe pasojat e keqpërdorimit të tyre te qytetarët në rajon, si te gratë po ashtu edhe te burrat. Të dhënat janë mbledhur për periudhën 2012-2016. Më përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe, të dhënat e paraqitura në këtë publikim i referohen këtij burimi.


2. Anketimi për perceptimin: Në nëntor dhe dhjetor të vitit 2017, SEESAC kreu një anketim online për perceptimin e publikut, për të kuptuar më mirë perceptimin publik rreth mbrojtjes dhe sigurisë, përdorimit dhe mbajtjes së armëve të zjarrit dhe ekspozimit ndaj dhunës me armë zjarri në EJL. Në total, 53 936 të intervistuar morën pjesë në anketimin online, në të gjithë Evropën Juglindore. 2560 të intervistuar plotësuan anketimin në Shqipëri.

3. Platforma e monitorimit të dhunës me armë (Armed Violence Monitoring Platform - AVMP): AVMP-ja monitoron incidentet me armë zjarri që kanë ndodhur në EJL që nga viti 2014. Të dhënat mbledhen çdo ditë duke përdorur artikujt e mediave lokale, motorët e kërkimit online dhe kur është e mundur, raportet e institucioneve publike për incidentet me armë zjarri. Për qëllime të kësaj analize, u analizuan 982 raportime për incidente, të shtrira në periudhën 1 janar 2014 deri më 31 dhjetor 2018.


GJETJET KRYESORE

- 99,9% e të gjithë armëve të zjarrit janë në pronësi të burrave ndërsa gratë zotërojnë vetëm 0,1% të armëve të zjarrit;
- Burrat përbëjnë shumicën dërrmuese të personelit të autorizuar për të mbajtur armë zjarri në sektorin e sigurisë;
- Burrat përbëjnë 99,6% të personelit të shoqërive të sigurisë të autorizuar për të mbajtur armë zjarri, krahasuar me vetëm 0,4% të grave;
- 27,9% e burrave dhe 16,5% e grave do të zotëronin një armë;
- 66,9% e grave dhe 52,5% e burrave ndihen më pak të sigurt me një armë në shtëpi;
- 30,8% e burrave dhe 14% e grave kanë pasur një lloj përvoje personale direkte me armët;
- 64,3% e të gjithë vrasjeve janë kryer me armë zjarri;
- Burrat përbëjnë 82,5% të viktimave të incidenteve me armë zjarri ndërsa gratë 17,5%;
- Për 20,5% të grave dhe 18,1% të burrave që ishin viktimë të incidenteve me armë zjarri, pasojat ishin fatale;
- 20,9% e viktimave të vrasjeve janë vrarë nga një anëtar i familjes;

- Burrat e moshës 19–35 vjeç janë më shpesh të ekspozuar ndaj keqpërdorimit të armëve të zjarrit dhe përbëjnë 37,9% të të gjitha viktimave të incidenteve me armë zjarri;
- 70,5% e të gjitha grave të vrara, janë vrarë nga anëtarët e familjes, krahasuar me 11,5% të burrave të vrarë;
- Partnerët intimë kanë kryer 41,7% të të gjitha vrasjeve të anëtarëve të familjes;
- 57,1% e grave të vrara nga anëtarët e familjes janë vrarë me armë zjarri, ndërsa nuk kishte asnjë rast të raportuar të burrave të vrarë me armë zjarri nga anëtarët e familjes;
- 27,8% e grave në Shqipëri, të vrara nga partneri intim në vitet 2015 dhe 2016, janë vrarë me armë zjarri;
- 26,3% e incidenteve të dhunës në familje, të cilat përfshinin armë zjarri, kishin pasoja fatale;
- Burrat kryen 98,1% të të gjithë incidenteve me armë zjarri, ndërsa gratë vetëm 1,9% të incidenteve;
- 53,7% e incidenteve me armë zjarri janë kryer nga burrat e moshës 19–35 vjeç;
- 76% e grave të vrara me armë zjarri janë vrarë në shtëpitë, apartamentet ose oborret e tyre;
- 40,8% e burrave të vrarë me armë zjarri janë vrarë në rrugë.



Personat e pajisur me leje për armë zjarri, sipas seksit, 2016



Aplikantët për leje të reja, sipas seksit dhe vitit

8
•Gra •Burra

1 / PRONËSIA, AKSESI DHE KËRKESA PËR ARMË ZJARRI

MBAJTJA E ARMËVE NGA CIVILËT


Burrat zotërojnë 99,9% të të gjithë armëve të zjarrit ndërsa gratë vetëm 0,1%

Zotërimi i armëve të zjarrit nga civilët në Shqipëri dominohet thellësisht nga burrat, ndërsa gratë zotërojnë vetëm një përqindje të vogël të armëve të zjarrit. Në vitin 2016, 96 685 burra dhe 85 gra ishin të pajisur me leje për armë zjarri.

Gjatë periudhës 2012-2016, burrat morën 99,5% të të gjitha lejeve, krahasuar me 0,5% të lejeve të marra nga gratë. Më konkretisht, në vitin 2016, 1069 burra dhe 11 gra aplikuan për leje të reja.

57,6% e të gjithë aplikantëve ishin burra të moshës 36 deri në 60 vjeç, pasuar nga burrat e moshës 18 deri në 35 vjeç, me 28,4%. Ndër gratë, 70,6% e aplikanteve femra bënë pjesë në grupmoshën 36 deri në 60 vjeç.

•Gra •Burra




Personeli i sektorit të sigurisë i autorizuar për të mbajtur armë zjarri, sipas seksit, 2016


SEKTORI I SIGURISË

Burrat përbëjnë shumicën dërrmuese të personelit të autorizuar për të mbajtur armë zjarri në sektorin e sigurisë


Në vitin 2016, 1295 burra dhe 58 gra në Ministrinë e Brendshme, 8597 burra dhe 921 gra në forcat e policisë dhe 2261 burra dhe 177 gra në shërbimet korrigjuese, ishin të autorizuar për të mbajtur armë zjarri.



Personeli i shoqërive private të sigurisë të autorizuar për të mbajtur armë zjarri, sipas seksit 2016



A do të mbanit një armë? - Po; sipas seksit dhe moshës, 2017 (Burimi: Anketimi për perceptimin)



A do të mbanit një armë? - Jo; sipas seksit dhe moshës, 2017 (Burimi: Anketimi për perceptimin)

Shoqëritë private të sigurisë

Burrat përbëjnë **99,6%** të personelit të shoqërive private të sigurisë të autorizuar për të mbajtur armë zjarri, krahasuar me vetëm **0,4%** të grave

Në vitin 2016, 8835 burra dhe 35 gra të punësuar nga shoqëritë private të sigurisë ishin të autorizuar për të mbajtur armë zjarri.


SJELLJET DHE KËRKESA PËR ARMË ZJARRI

27,9% e burrave dhe **16,5%** e grave të anketuara në vitin 2017 do të zotëronin një armë

Burrat e moshës 16 deri në 24 vjeç kanë më shumë gjasa të thonë se do të zotërojnë një armë, pasuar nga ata të moshës 45 deri në 54 vjeç. Ndër gratë, të intervistuarat e grupmoshës 16 deri në 24 vjeç kishin më shumë gjasa të thoshin se do të zotëronin një armë.

Megjithatë, shumica e grave dhe burrave, përkatësisht **83,5%** dhe **72,1%**, nuk do të zotëronin një armë

Gratë e moshës 25 deri në 34 vjeç kanë më pak gjasa të thonë se do të zotërojnë një armë.



• Gra • Burra

Pasja e një arme në shtëpi do t'ju bënte të ndiheshit më të sigurt apo më pak të sigurt?, sipas seksit, 2017 (Burimi: Anketimi për perceptimin)




Edhe pse 16,5% e grave thanë se do të zotëronin një armë, ato përbënin vetëm 1% të aplikanteve për leje të reja në vitin 2016

66,9% e grave dhe 52,5% e burrave ndihen më pak të sigurt me një armë në shtëpi

Gratë kanë shumë më tepër gjasa që të ndihen më pak të sigurt me një armë në shtëpi ndërsa burrat janë të ndarë rreth kësaj çështjeje. Burrat e moshës 16 deri në 24 vjeç kanë më tepër gjasa të ndihen më të sigurt me një armë në shtëpi (55,7%), ndërsa gratë e moshës 55 deri në 64 vjeç kanë më tepër gjasa të ndihen më pak të sigurt me një armë në shtëpi (75%).

2 / PËRVOJA




• Gra • Burra

Keni pasur përvojë me përdorimin e armës?, sipas seksit, 2017 (Burimi: Anketimi për perceptimin)



30,8 e burrave dhe 14% e grave kanë pasur një lloj përvojë personale direkte me armët – kanë përdorur armë, u është drejtuar arma ose të dyja


Edhe pse ka dallime ndërmjet burrave dhe grave rreth përvojave me armë, ato janë veçanërisht të konsiderueshme në aspektin e përdorimit të armëve të zjarrit – 17,7% e burrave raportuan se kanë përdorur një armë, krahasuar me 7% të grave.



Vrasjet me armë zjarri përkundrejt totalit të vrasjeve, 2012-2016


• Armë zjarri
• Mjete të tjera

14



Viktimat e incidenteve me armë zjarri, sipas seksit, 2014-2018 (Burimi: AVMP)

• Gratë • Burra



Viktimat e incidenteve me armë zjarri, sipas seksit dhe moshës, 2014-2018 (Burimi: AVMP)

• Gratë • Burra

3 / VIKTIMAT


64,3% e të gjithë vrasjeve janë kryer me armë zjarri

Arma e zjarrit janë mjeti i zgjedhur që mbizotëron më së shumti në kryerjen e një vrasjeje. 354 nga 550 persona të vrarë ndërmjet viteve 2012 dhe 2016, janë vrarë me një armë zjarri.


Burrat përbëjnë 82,5% të viktimave të incidenteve me armë zjarri ndërsa gratë 17,5%¹

Burrat e moshës 19 deri në 35 vjeç janë më shpesh të ekspozuar ndaj keqpërdorimit të armëve të zjarrit dhe përbëjnë 37,9% të të gjitha viktimave të incidenteve me armë zjarri. Burrat e moshës 36 deri në 60 vjeç renditen të dytët pasuar nga grupmosha 61 vjeç e sipër, dhe gratë e moshës 36 deri në 60 vjeç si dhe ato të grupmoshës 61 vjeç e sipër.

¹ Bazuar në analizën e 982 incidenteve të kapura përmes AVMP-së. Analiza identifikoi 127 viktime femra dhe 599 viktime meshkuj, ndërsa për 58 prej viktimave nuk u raportua lloji i seksit.



Rezultati i incidenteve me armë zjarri sipas seksit të viktimës, 2014-2018, (Burimi: AVMP)



Vrasjet e anëtarëve të familjes përkundrejt vrasjeve të tjera, 2012-2016



Vrasjet në familje përkundrejt totalit të vrasjeve, sipas seksit, 2012-2016



Vrasjet nga partnerët intimë përkundrejt totalit të vrasjeve, sipas seksit 2012-2016

Për 20,5% të grave dhe 18,1% të burrave që ishin viktimat të incidenteve me armë zjarri, pasojat ishin fatale.

Mundësia për të pasur pasojë fatale është proporcionalisht më e lartë te gratë se sa te burrat. Gjithashtu, gratë kanë më tepër gjasa të kërcënohen me armë zjarri, ndërsa burrat kanë shumë më tepër gjasa të plagosen ose kryejnë vetëvrasje.

DHUNA NË FAMILJE

20,9% e personave të vrarë në Shqipëri janë vrarë nga një anëtar i familjes

Ndërmjet viteve 2012 dhe 2016, 115 nga 550 vrasje të raportuara në total, ishin kryer nga anëtarët e familjes.


Gratë tejkalojnë burrat si viktimat të vrasjeve të kryera nga një anëtar i familjes, ku numri i grave të vrara nga anëtarët e familjes ishte 62 (53,9%) dhe i burrave 53 (46,1%). Dhuna në familje prek si gratë ashtu dhe burrat, por modelet e viktimizimit janë të ndryshme.

70,5% e të gjitha grave të vrara në Shqipëri, janë vrarë nga anëtarët e familjes, krahasuar me 11,5% të burrave të vrarë

Partnerët intimë kanë kryer 41,7% të të gjitha vrasjeve të anëtarëve të familjes.

Gjatë periudhës 2012-2016, 48 persona, nga të cilët 42 gra dhe 6 burra janë vrarë nga partnerët e tyre intimë, përkatesisht 87,5% dhe 12,5%.

Gratë janë veçanërisht në rrezik nga vrasjet nga partneri intim. 47,7% e grave të vrara në Shqipëri janë vrarë nga partneri i tyre intim (42 nga 88), krahasuar me 1,3% të burrave (6 nga 462).




Vrasjet e anëtarëve të familjes, sipas mjetit, 2015-2016

• Armë zjarri
• Mjete të tjera




Vrasjet e anëtarëve të familjes, të kryera me armë zjarri, përkundrejt totalit të vrasjeve në familje, sipas seksit, 2015-2016

• Gra • Burra



Gratë e vrara nga partneri intim me armë zjarri dhe mjete të tjera, 2015-2016

• Armë zjarri
• Mjete të tjera



Shpeshhtësia e pasojave fatale sipas llojit të incidentit, 2014-2018

↙

32,4% e të gjithë vrasjeve të anëtarëve të familjes janë kryer me armë zjarri

Në 12 nga 37 vrasjet e kryera nga anëtarët e familjes² në vitet 2015 dhe 2016, armët e zjarrit ishin mjeti i zgjedhur.

57,1% e grave të vrara nga anëtarët e familjes janë vrarë me armë zjarri, ndërsa nuk kishte asnjë rast të raportuar të burrave të vrarë me armë zjarri nga anëtarët e familjes

Nga të 12 personat e vrarë me armë zjarri, të gjitha ishin gra.


27,8% e grave në Shqipëri, të vrara nga partneri intim në vitet 2015 dhe 2016, janë vrarë me armë zjarri

5 nga 18 gratë e vrara nga partneri i tyre intim në vitet 2015 dhe 2016, janë vrarë me armë zjarri, ndërkohë që nuk ka pasur asnjë rast të raportuar të burrave të vrarë me armë zjarri nga partnerja e tyre intime.

26,3% e incidenteve të dhunës në familje, të cilat përfshinin armë zjarri, kishin pasoja fatale

Keqpërdorimi i armëve të zjarrit në dhunën në familje është më fatal se në çdo lloj tjetër incidenti dhe është 1,5 herë më vdekjeprurës se sa në incidentet kriminale.

² Të dhënat për numrin e personave të vrarë me armë zjarri nga anëtarët e familjes, ishin të disponueshme vetëm për vitet 2015 dhe 2016. Në total, 37 persona janë vrarë nga anëtarët e familjes në vitet 2015 dhe 2016, 12 prej tyre me armë zjarri.




Aplikantët e refuzuar për leje të reja, sipas arsyeve të refuzimit, 2012-2016

20

Gjatë periudhës 2012–2016, 23,8% të aplikantëve ju refuzua leja mbi baza të dhunës në familje


Nga 868 aplikantët për leje për armë zjarri, aplikimet e të cilëve janë refuzuar ndërmjet viteve 2012 dhe 2016, 207 u refuzuan mbi baza të dhunës në familje. Ndonëse precedenti penal për dhunë në familje është shpeshherë arsyeja për refuzimin e aplikimit për leje për armë zjarri, gjatë periudhës së anketimit numri i aplikantëve të refuzuar ra ndjeshëm, me më shumë se katër herë, me numrin më të ulët në vitin 2016.



Lejet e revokuara, sipas arsyeve të revokimit, 2012-2016

9,2% e të gjitha lejeve të revokuara për armë zjarri, u revokuan si pasojë e dhunës në familje

106 nga 1156 lejet e revokuara nga viti 2012 deri në 2016, u revokuan mbi bazat e dhunës në familje.




Autorët e incidenteve me armë zjarri, sipas seksit, 2014-2018 (Burimi: AVMP)


• Gira • Burra

4 / AUTORËT

Burrat kryen 98,1% të të gjithë incidenteve me armë zjarri, ndërsa gratë vetëm 1,9% të incidenteve



Autorët e incidenteve me armë zjarri, sipas seksit dhe moshës, 2014-2018 (Burimi: AVMP)




Marrëdhënia ndërmjet viktimës dhe autorit të incidenteve me armë zjarri, sipas seksit, 2014-2018 (Burimi: AVMP)

Meshkujt në moshë të re kanë më tepër gjasa të kryejnë incidente me armë zjarri



53,7% e të gjithë incidenteve me armë zjarri ishin kryer nga burra të moshës 19 deri në 35 vjeç, pasuar nga burrat e moshës 36 deri në 60 vjeç, me 32,7%.

MARRËDHËNIA NDËRMJET VIKTIMËS DHE AUTORIT TË INCIDENTEVE ME ARMË ZJARRI

Gratë rrezikohen më tepër nga keqpërdorimi i armëve të zjarrit nga partnerët intimë dhe anëtarët e tjerë të familjes. Burrat rrezikohen kryesisht nga miqtë/të njohurit/fqinjët pasuar nga anëtarët e familjes dhe të panjohurit



Burrat përbëjnë 99,9% të zotëruesve të armëve të zjarrit dhe kryejnë 98,1% të incidenteve me armë zjarri. Gjithashtu, ata përbëjnë shumicën e viktimave të incidenteve me armë zjarri (82,5%), por proporcionalisht janë më shpesh autorë se sa viktimat të keqpërdorimit të armëve të zjarrit. Nga ana tjetër, gratë zotërojnë vetëm 0,1% të armëve të zjarrit, përbëjnë 1,9% të autoreve të veprave penale me armë zjarri dhe 17,5% të viktimave.



Vendndodhja e vrasjeve me armë zjarri, sipas seksit, 2014-2018
(Burimi: AVMP) ↑

76% e grave dhe 30,6% e burrave të vrarë me armë zjarri janë vrarë në shtëpitë, apartamentet ose oborret e tyre

Gratë kanë 2,5 herë më shumë gjasa se burrat që të vriten në hapësirat e tyre private.

40,8% e burrave dhe 20% e grave të vrara me armë zjarri janë vrarë në rrugë

Burrat kanë dy herë më shumë gjasa se gratë që të vritet në këto ambiente.

CIP - Каталогизација у публикацији
Народна библиотека Србије, Београд

623.44:305-055.1/.2(496.5)"2012/2107"

BOŽANIĆ, Dragan, 1975-

Fakte të shpejta mbi gjininë dhe armët e zjarrit në Shqipëri / [ky raport u hartua nga Dragan Božanić]. - Beograd : UNDP SEESAC, 2019 (Beograd : Cicero). - 27 str. : tabele, graf. prikazi ; 30 cm

Tiraž 100.

ISBN 978-86-7728-273-8

a) Оружје -- Родни аспект -- Албанија -- 2012-2017 --
Статистика б) Ватрено оружје -- Родни аспект -- Албанија --
2012-2017 -- Статистика

COBISS.SR-ID 281009164





*Empowered lives.
Resilient nations.*

South Eastern and Eastern Europe Clearinghouse
for the Control of Small Arms and Light Weapons (SEESAC)

Bulevar Zorana Đinđića 64, 11000 Belgrade, Serbia

Tel: +381 11 415 5300

Fax: +381 415 5499

E-mail: seesac@undp.org

www.seesac.org



*This project is funded by
the European Union*

Working within the framework of:



Regional Cooperation Council

#SaferRegion